

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE
 MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY
 SEKTORI I ARKIVIT - SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësi Org: 218 Nr. Prot: 5522
 Org. Jedinica: Org. Unit: Broj Prot: 5522
 Nr. i faqeve: 4 Data: 18/10/2013
 Br. stranica: No. pages: Prishtinë / a



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
 Ministry of Education, Science and Technology**

DATË/A:	18.10.2013
REFERENC-Ë:	2/8 - 2290
PËR/ZA/TO:	Grupin Ndërmënytor kundër Trafikimit me Njerëz
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Xhavit Dakaj, Sekretar i përgjithshëm në MASHT
NGA/OD/FROM:	Merita Jonuzi, Koordinatore në Njësinë e të Drejtave të Njeriut, MASHT
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shënimi i Muajit Antitrafikim 2013

Të nderuar/a,

Ju njoftojmë se aktivitetet e planifikuara nga Njësia për të Drejtat e Njeriut/ MASHT për shënimin e Muajit/ Fushatës Antitrafikim janë realizuar me sukses sipas planifikimit.



Aktivitetet tona ishin përqendruar në 5 komuna, me diskutimet në këto 10 shkolla:

1. Shkolla Parafillore, Fillore dhe e Mesme e Ulët: "Ismet Rraci", Klinë
2. Shkolla Parafillore, Fillore dhe e Mesme e Ulët: "Atë Shtjefan Gjeqovi", Klinë,
3. Shkolla Parafillore, fillore dhe e Mesme e Ulët: "Jusuf Gërvalla", Glllogovc
4. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët: "Xheladin Gashi - Plaku", Komoran
5. Shkolla e Mesme e Lartë Teknike: "11 Marsi" Prizren
6. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët: "Svjetlost", Manastir/ Prizren
7. Shkolla Parafillore, Fillore dhe e Mesme e Ulët: "Shaban Jashari", Skënderaj
8. Shkolla Parafillore, Fillore dhe e Mesme e Ulët: "Idriz Berani", Klinë e Epërme, Skënderaj
9. Shkolla Parafillore, Fillore dhe e Mesme e Ulët: "Bafti Haxhiu", Viti
10. Shkolla Parafillore, Fillore dhe e Mesme e Ulët: "Safet Rexhepi", Zhiti/ Viti

Në të gjitha shkollat u pa ndjeshmëria e plotë ndaj fushatës, si në debatet me nxënës e mësime dhënë, ashtu edhe në punën e tyre të reflektuar në ekspozita të veçanta.



Pas ligjëratave kemi zhvilluar diskutime të hapura, me ç'rast vlerësoj se nxënësit dhe mësime dhënësit e lëndëve adekuate ku trajtohet tema e trafikimit, kishin mjaft informacione, ndërkaq mësime dhënësit e tjerë, të cilët gjithashtu duhet ndihmojnë punën e parandalimit nëpërmjet të edukimit, nuk kishin mjaft njohuri për problemin në fjalë dhe për qasjen që duhet ta ketë institucioni arsimor.

Përgjithësisht konsiderojmë se ligjëratat tona e kanë arritur efektin e dëshiruar në sensibilizimin e mësime dhënësit dhe nxënësve në shkollat e përfshira, të cilave përveç materialeve promovuese kundër trafikimit me njerëz, u kemi ndarë dhurata mjaft cilësore: pajisje laboratorike për konkretizimin e përmbajtjeve të ndryshme lëndore.

Nxënësit e përfshirë në ligjëratat u zotuan se informacionet e pranuar nga ne do t'i ndajnë me bashkëmoshatarët dhe familjet e tyre.



Shkollave kryesisht u janë shpërndarë këto pajisje:

- Trupi anatomik i njeriut
- Zemra e njeriut (trepjesëshe-model)
- Truri i njeriut (4 pjesësh)
- Komplet trekëndështa me kompasa
- Kitare
- Topa
- Skeleti i trupit të njeriut

- Bretkoca me prerje tërthore
- Syri (trepjesësh model)
- Mikroskop shkollor
- Trupi i njeriut me organe

P.s ndërkohë ua dërgojmë të gjitha fotot e realizuara nëpër shkolla

Ju faleminderit për vëmendjen Tuaj!